



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 396/1 Prot.

Tiranë, më 29 /05/2015

VENDIM
“ Për mospranimin e ankesës ”

Nr. 34 , datë 29/05/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 396 Prot., datë 11.05.2015, ndaj autoritetit publik/ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/ Z. në cilësinë e kërkuesit ka kërkuar informacion, me shkresën datë 10.02.2015 drejtuar autoritetit publik/ Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë lidhur me certifikatën e pronësisë.

Komisioneri, në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas së cilës, *ankimi administrativ pranë Komisionerit bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur ankuesi ka marrë njoftimin për refuzimin e informacionit ose ka kaluar afati i parashikuar në ligj për dhënien e informacionit.*

Sa më sipër rezulton se ankesa e Z. nuk është bërë brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) i) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 396 Prot., datë 11.05.2015 të Z. , ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 29.05.2015.

